



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

1884/
Nr. Prot.
Datë 16.10.2023

MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

6539/2
Nr. Prot.
Datë 19.10.2023

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 28, datë 16.10.2023

PËR

**KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR TRANSFERIMIN NGA ARSIMI I
PËRGJITHSHËM (GJIMNAZ) NË ARSIMIN PROFESIONAL DHE ANASJELLTAS**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 20 pika 5 të ligjit nr. 15/2017, datë 16.02.2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJMË:

**Neni 1
Qëllimi**

Ky udhëzim i përbashkët ka për qëllim të përcaktojë kushtet dhe procedurat për realizimin e transferimit nga arsimi i përgjithshëm (gjimnaz), në arsimin e mesëm profesional dhe anasjelltas.

**Neni 2
Kushtet për transferim nga arsimi i mesëm profesional, në arsimin e përgjithshëm
(gjimnaz)**

1. Kanë të drejtë të transferohen në gjimnaz nxënësit që kanë përfunduar klasën e dhjetë të arsimit të mesëm profesional.

2. Nxënësit duhet të plotësojnë kriterin e moshës të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për sistemin arsimor parauniversitar.
3. Transferimi nga arsimi i mesëm profesional, në gjimnaz bëhet me miratim të Zyrës Vendore Arsimore Parauniversitare (ZVAP) përkatëse.

Neni 3

Procedurat e transferimit nga arsimi i mesëm profesional, në arsimin e përgjithshëm (gjimnaz)

1. Procedurat e transferimit fillojnë pas përfundimit të vitit shkollor dhe vijojnë deri në fund të muajit korrik.
2. Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore të nxënësit, bën aplikimin *on-line* për transferim, nëpërmjet platformës *e-albania*, në shërbimin përkatës dhe ngarkon dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Dokumentin e identifikimit të nxënësit;
 - b) Dëftesën e klasës së 10-të të arsimit të mesëm profesional.
3. ZVAP, ku është paraqitur aplikimi për transferim, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga përfundimi i afatit për aplikim, kryen procedurat si vijon:
 - a) Vlerëson dokumentacionin e aplikimit dhe miraton ose refuzon kërkesën për transferim, nëpërmjet platformës *e-albania*. Për rastet kur kërkesa refuzohet, ZVAP duhet të argumentojë shkakun e refuzimit;
 - b) Krahason planin mësimor të klasës së 10-të të arsimit të mesëm profesional që ka përfunduar nxënësi, me planin mësimor të klasës së 10-të të gjimnazit ku nxënësi dëshiron të transferohet. Në rast se nga krahasimi i planeve mësimore, rezulton se në arsimin profesional ka të paktën 6 lëndë/module të pazhvilluara, atëherë nxënësi duhet të përsërisë klasën e 10-të;
 - c) Njofton zyrtarisht drejtorinë e institucionit arsimor ku nxënësi do të transferohet për lëndët/modulet e pazhvilluara dhe të zhvilluara pjesërisht.
4. Drejtoria e institucionit arsimor parauniversitar, menjëherë pas marrjes së njoftimit zyrtar nga ZVAP për transferimin e nxënësit, cakton mësuesit e secilës lëndë të pazhvilluar ose të zhvilluar pjesërisht, për t'i dhënë nxënësit orientimet e nevojshme, për t'u përgatitur për kryerjen e provimeve për këto lëndë.
5. Provimet për lëndët e zhvilluara pjesërisht, kryhen vetëm për pjesën e programit mësimor të përcaktuar, e cila përcaktohet nga mësuesi lëndor dhe miratohet nga drejtoria e institucionit arsimor parauniversitar.
6. Nxënësi i kryen këto provime në sesionin e vjeshtës, sipas procedurave të përcaktuara për provimet e këtij sesioni.

7. Nxënësi shtetas shqiptar apo i huaj, i cili transferon studimet nga arsimi i mesëm profesional i kryer jashtë shtetit, në gjimnaz, në Republikën e Shqipërisë, duhet të njohë dhe njihsojë dëftesën e përfundimit të klasës së 10-të. Ata nuk mund të ripërsërisin lëndë për të cilat janë vlerësuar njëherë.
8. Pas përfundimit të procedurave të transferimit, shkolla pritëse njofton zyrtarisht shkollën nga është transferuar nxënësi, për regjistrimin e nxënësit. Të dy shkollat bëjnë shënimet përkatëse në amëz.
9. Dokumentacioni i transferimit ruhet në sekretarinë e institucionit arsimor parauniversitar dhe është objekt inspektimi, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4

Kushtet e transferimit nga arsimi i përgjithshëm (gjimnaz), në arsimin e mesëm profesional

1. Transferimi i nxënësit nga gjimnazi, në arsimin e mesëm profesional lejohet vetëm brenda 3 mujorit të parë të klasës së 10-të. Ky rregull vlen edhe kur nxënësi ka ndjekur arsimin e përgjithshëm parauniversitar jashtë vendit.
2. Për t'u transferuar nxënësi duhet të plotësojë detyrimet e planit mësimor (lëndët dhe modulet profesionale) të drejtimit përkatës të arsimit të mesëm profesional ku kërkon të transferohet.
3. Nxënësit të cilët transferojnë studimet nga jashtë shtetit në Republikën e Shqipërisë, për periudhën e 3 mujorit të parë të vitit të parë të arsimit të mesëm të përgjithshëm, duhet të paraqesin programin mësimor të ndjekur në atë shtet, të përkthyer dhe noterizuar me vulë apostile.
4. Nxënësit duhet të plotësojnë kriterin e moshës të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për sistemin arsimor parauniversitar.

Neni 5

Procedurat e transferimit nga arsimi i përgjithshëm (gjimnaz), në arsimin e mesëm profesional

1. Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore të nxënësit, bën aplikimin *on-line* për transferim, nëpërmjet platformës *e-albania* dhe ngarkon dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Dokumentin e identifikimit të nxënësit;
 - b) Vërtetimin e ndjekjes së gjimnazit nga data e fillimit të shkollës deri në momentin e aplikimit. Vërtetimi përmban lëndët e zhvilluara, rezultatet për çdo lëndë, frekuentimin, si dhe masat disiplinore, nëse ka.

2. Drejtoria e shkollës së arsimit të mesëm profesional, ku nxënësi dëshiron të transferohet, brenda 5 (pesë) ditë pune, nga kryerja e aplikimit, kryen këto procedura:
 - a) Vlerëson dokumentacionin e aplikimit dhe miraton ose refuzon kërkesën për transferim;
 - b) Për të dy rastet, miratim apo refuzim, krahas njoftimit nëpërmjet platformës e-albania, njofton edhe zyrtarisht (me shkresë ose e-mail) personin që ushtron përgjegjësi të prindërore. Për rastet kur kërkesa refuzohet, duhet të jepet edhe shkaku i refuzimit.
 - c) Në rast miratimi, njofton zyrtarisht drejtorinë e shkollës nga vjen nxënësi, për miratimin e transferimit. Të dyja shkollat, transferuese dhe pritëse, bëjnë shënimet përkatëse në dokumentacionin shkollor sipas legjislacionit në fuqi.
 - d) Cakton mësuesit e lëndëve/moduleve profesionale të pazhvilluara ose të zhvilluara pjesërisht gjatë 3 mujorit të parë, të cilët do të mbështesin nxënësit për plotësimin e boshllëqeve në përgatitjen teorike dhe praktike profesionale.
3. Mësuesit sipas shkronjës d) të pikës 2, të këtij Udhëzimi, brenda tremujorit të dytë testojnë dhe vlerësojnë me notë nxënësit, për lëndët/modulet profesionale përkatëse.
4. Në përfundim të vlerësimit, mësuesit dokumentojnë dhe dorëzojnë në drejtorinë e shkollës rezultatet e vlerësimit, të cilat pasqyrohen në dokumentacionin shkollor.
5. Dokumentacioni i transferimit ruhet në sekretarinë e institucionit arsimor dhe është objekt inspektimi.

Neni 6

Dispozitat e fundit

1. Lëndë/module të pazhvilluara plotësisht konsiderohen ato lëndë/module të cilat janë në planin mësimor të shkollës ku nxënësi dëshiron të transferohet, por nuk janë në planin mësimor të shkollës nga vjen nxënësi.
2. Lëndë/module të zhvilluara pjesërisht janë ato lëndë/module të cilat në planin mësimor të shkollës ku nxënësi dëshiron të transferohet, zhvillohen me më shumë orë mësimore në javë, nga sa janë zhvilluar në shkollën nga vjen nxënësi.
3. Vlerësimi përfundimtar për lëndët e zhvilluara pjesërisht është mesatarja aritmetike e vlerësimit të shkollës nga vjen nxënësi, me vlerësimin e komisionit të shkollës ku nxënësi është transferuar.
4. Udhëzimi i përbashkët nr. 21, datë 9.7.2015, “Për procedurat e transferimit të nxënësve nga një nivel/drejtimit i arsimit profesional në gjimnaz“, shfuqizohet.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar,

Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, ofruesit e arsimit dhe formimit profesional dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR
I FINANCAVE DHE EKONOMISË**

ERVIN METE



**MINISTËR
I ARSIMIT DHE SPORTIT**

OGERTA MANASTIRLIU

